



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . __. 2018

V E N D I M

Nr. 103 , Datë 12. 04. 2018

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.30 Regjistri datë 28.02.2018, e znj.M. Z, kundër firmës së ndërtimit “Infinit Construction” Berat, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Subjekti ankues, znj.M. Z përmes ankesës së saj shprehet se në muajin Nëntor 2017 është larguar nga puna nga ana e firmës së pastrimit “Infinit Construction”, Berat. Ankuesja shprehet se ajo paguhej një herë në tre muaj dhe lidhur me këtë është ankuar, por ankesat e saj nuk janë marrë parasysh nga ana e firmës, duke e diskriminuar atë për shkak të racës së saj egjiptiane, duke e larguar përfundimisht nga puna.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri që të bëjë rikthimin e saj në vendin e punës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Me datë 11.04.2018 subjekti ankues ka paraqitur pranë Komisionerit një deklaratë me shkrim dore¹, me anë të së cilës kërkon të ndërpritet procedura e shqyrtimit të ankesës së saj, duke informuar se nuk ka më interes pasi ka filluar punë sërisht.

¹ Një kopje e deklaratës është depozituar në dosjen personale të ankueses.

- Neni 32, pika 3, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se: *“Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohn nga ky ligj”*.
- Pika 1, e nenit 94 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, përcakton se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, **organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”**”*.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 3, e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në nenin 94, pika 1, e Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mos marrjen në shyrtim të ankesës së znj.M. Z, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa e bërë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha : Punësim
Shkaku: Raca